



Prezantim i radios (Multiplatformat)

Dr. Gjylie Rexha
18.03.2019, UBT - Prishtinë

Radio si media shumëplatformëshe

- Historikisht radio është ngritur si media masive, por e cila ka shfrytëzuar teknologjitë e shekullit XX për të zhvilluar afërsinë me dëgjuesit, duke mbetur media shoqërore dhe e sfondit.
- Në shekullin e “revolucionit dixhital”, të shumësishë së kanaleve dhe mundësive të pakufishme për përcjelljen e informacionit, radio shfrytëzon veçoritë karakteristike të medias masive që ndërton komunikim të personalizuar, për të ruajtur vendin e saj në ekosistemet e mediave.
- E cilësuar nga studiuesit si “Hirushe mediatike”, radio përdor teknologjitë e avancuara të shekullit XXI për të funksionuar si media shumëplatformëshe.
- Paralelisht me transmetimin përmes valëve (frekuencave), teknologjitë e reja i mundësojnë asaj që të shfrytëzojë platforma shtesë si kanale për përcjelljen e përmbajtjes.

- Në nivelin më të thjeshtë, kjo nënkupton që radio tejkalon konceptin tradicional sipas të cilit ajo ishte media që pranohet vetëm me të dëgjuar.
- Radio zhvillon faqe të veçanta në ueb në të cilat, materialet e transmetuara me zë në valët e saj, i ofrohen audiencës edhe në formën e tekstit. Pra, ajo nuk ka më vetëm dëgjuesit, por edhe lexuesit.
- Kjo mënyrë e shumëfishimit të përmbajtjes ndikon në:
 - zgjerimin e audiencave dhe
 - lehtësimin e marrjes (konsumimit) të përmbajtjes radiofonike.
- Përmbajtja nuk humb cilësitë e saj, përkundrazi ajo shndërrohet në produkt me vlerë të shtuar, që arrin të më shumë marrës në cilësinë e dëgjuesve, të cilët nuk kanë arritur ta marrin si përmbajtje “me një të dëgjuar” dhe të lexues të rinjë në “rrjetin e rrjeteve”.

- Me zhvillimin e formave të reja të përcjelljes së përmbajtjes në formatin *podcast*, radio ka kaluar transformimin tjetër të madh. Programet e saj nuk janë më përmbajtje që dëgjuesit i ofrohen në orare të përcaktuara paraprakisht.
- Programet bëhen të qasshme kurdo dhe në cilëndo platformë dhe format që dëgjuesi/lexuesi i dëshiron.
- Përparësitë që ofron ueb-i nuk ndalen vetëm te faqa e radios në linjë.
- Për të përmbushur pjesën e kërkesës së dëgjuesit/lexuesit, radio shfrytëzon teknologjitë dhe media të reja për të shpërndarë përmbajtjen.
- Tradicionalisht, programi i radios përbëhet nga “copëza” programore (emisione, intervista, reportazhe, kronika etj.) Cilado prej tyre mund të jetë edhe pjesë e strukturës së përgjithshme të programit edhe të transmetohet si pjesë e vetme.
-

- Lajmi i shkurtër dhe i qartë me parimet e të shkruarit për radion tradicionale, ka mbetur lajm i pranueshëm dhe i kuptueshëm edhe për dëgjuesin/lexuesin dinamik të shekullit XXI.
- Raporti është prapë “guri themeltar” që audiencës vazhdimisht në lëvizje i jep detaje të mjaftueshme dhe e mban në rrjedhë të ngjarjes varësisht nga ritmi i zhvillimit të saj me fuqinë karakteristike të përditësimit të informacionit në radio.
- Intervista kuptimplote, me pyetjet e shkurtëra dhe mundësitë e zgjeruara të radios për realizimin e saj, është model që zbatohet si praktikë edhe në mediat tjera të reja të këtij shekulli.
- Reportazhi është bërë edhe më tërheqës, me mundësitë për pasurimin e tij me efektet që gjenden dhe realizohen gjithnjë e më lehtë falë teknologjive të sofistikuar.
- Realizimi i radiodokumentarëve cilësor është bërë më i lehtë, sepse komunikimi me burimet dhe qasja në informacione janë më të mëdha.

- Realizimi i emisioneve *live* vazhdon të jetë ndër vlerat kryesore dalluese të radios në ekosistemet mediatike.
- Nëpër rrjetet sociale, apo platforma të tjera (facebook, youtube, aplikacione tjera), secila prej tyre mund t'iu ofrohet grupeve të vogla të audiencave, varësisht nga interesi që kanë përmbajtjen përkatëse.
- Të zhvillosh radio shumëplatformëshe nënkupton zotërimin e sa më shumë teknikave të kombinuara për përgatitjen e përmbajtjes tërheqëse dhe të njohësh platformat e reja si mundësi shtesë për përcjelljen e përmbajtjes të audiencat.

Radio për gazetarët shumëdetyrësh

- Historikisht radio është zhvilluar si media e gazetarëve shumëdetyrësh, vetëm se më me pak detyra se tani.
- Radio është zhvilluar si media në të cilën karakteristikë e procesit të punës është që të bësh vetë shumëçka dhe në të njëjtën kohë.
- Gazetari i radios ishte profesionisti që përsos teknikat e incizimit, editimit, kryente edhe punën e redaktorit, ishte edhe moderator; në radio me numër të vogël të stafit ishte pjesë përbërëse e planifikimit për shpërndarjen në program të materialeve, apo gjendej në rolin e producentit.
- Prandaj, në vend që të flitet për diçka plotësisht të re, angazhimet e gazetarit të radios tani përkufizohen si reformësim i vlerave në përputhje me kërkesat dhe mundësitë e reja.

Radiogazetari dhe radio te ne

- Me aftësinë e vazhdueshme të transformimit si kompani mediatike dhe si përmbajtje, radio vazhdon të jetë pjesë e rëndësishme e ekosistemit të mediave.
- Si të tillë, në programin e fakultetit tonë i japim peshën e medias, për të cilën studentët marrin njohuritë teorike dhe praktike, që u mundësojnë të përgatiten si profesionistë në lëmin e radiogazetarisë dhe në menaxhimin e kompanive radiofonike.
- Njohuritë nga teoria, studentët kanë mundësi që t'i zbatojnë drejtpërdrejt në studion e radios së UBT-së. Kjo mënyrë e funksionimit është treguar e suksesshme, me rezultate të shumta, qoftë në përgatitjen e programeve dhe materialeve nga studentët, qoftë edhe me angazhimin e tyre nëpër radio të ndryshme në Kosovë.

- Në realitetin mediatik të Kosovës, radio mbetet media e rëndësishme, por e cila përballet ende me sfidat e procesit të konvergencës.
- Një pjesë e kompanive radiofonike ende vazhdojnë me skemat tradicionale të transmetimeve vetëm përmes frekuencave. Pjesa tjetër është zhvilluar, apo kanë nisur zhvillimin edhe në platformat e reja.
- Në vazhdimin e kësaj vizite ju do të keni mundësinë të njiheni me “*Kampus Radio*”, e cila zhvillohet sipas modelit që kombinon transmetimin përmes valëve dhe si ueb radio.